


OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

Shqipëria 2022





Pikëpamjet dhe përfundime të shprehura në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Qeverisë së Zvicrës apo Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC

OBJEKTIVAT

E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

Shqipëria 2022

OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM SHQIPËRIA 2022

Drejt看 botimi: Dr. Elsa Dhuli

Përgatur nga:

Vjollca Simoni
Blerta Muja
Rustem Ndroqi
Aida Boduri
Olta Caca
Anisa Omuri
Elda Muça
Ornela Shani
Isida Gorce
Endrit Preçi
Gentian Sinakoli
Deana Delaj
Elma Çali


© Copyright INSTAT 2023

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij
në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të
mbajtësit të së drejtës së autorit.

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Kodi Postar 1017
Tel: + 355 4 2222411 / 2233356
Fax: +355 4 2222 411
e-mail: info@instat.gov.al
www.instat.gov.al

Përmbajtja

OZHQ 1: Pa Varfëri	8
OZHQ 2: Zero Uri	12
OZHQ 3: Shëndeti i Mirë dhe Mirëqenie	16
OZHQ 4: Arsimit Cilësor	22
OZHQ 5: Barazi Gjinore	28
OZHQ 6: Ujë i Pastër dhe Shërbime Sanitare	34
OZHQ 7: Energji e Përbalueshme dhe e Pastër	38
OZHQ 8: Punë Dinjitoze dhe Rritje Ekonomike	42
OZHQ 9: Industri, Inovacion dhe Infrastrukturë	46
OZHQ 10: Zvogëlim i Pabarazive	50
OZHQ 11: Qytete dhe Komunitete të Qëndrueshme	54
OZHQ 12: Konsumi dhe Prodhimi i Përgjegjshëm	58
OZHQ 13: Veprim për Klimën	62
OZHQ 14: Jeta Nën Ujë	64
OZHQ 15: Jeta në Tokë	66
OZHQ 16: Paqe, Drejtësi dhe Institucione të Forta	70
OZHQ 17: Partneritet për Objektivat	74



Instituti i Statistikave të Shqipërisë vazhdon t'i kushtojë një rëndësi të veçantë OZHQ-ve, pasi statistikat janë instrumenti i zgjedhur për të vendosur bazën për monitorimin e zbatimit të këtyre qëllimeve në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Politikat dhe strategjitë që duhet të zhvillohen për arritjen e 17 objektivave dhe 169 targeteve duhet të mbështeten nga treguesit statistikorë për një vendimmarrje të bazuar në evidenca.

INSTAT së bashku me Ministrinë e Linjës dhe disa institucione të tjera, është pjesë e grupit teknik ndër-institucional të punës për OZHQ-të, drejtuar nga Kryeministria.

Aktualisht INSTAT prodhon 61 indikatorë statistikorë, të cilët përditësohen në platformën për OZHQ-të <http://instat.gov.al/al/sdgs/>, krijuar në bashkëpunim me PNUD-in. Ky Dashboard përmban SDG-të me 17 objektivat, ku janë të paraqitura përkufizimet, drejtimi, përafrimi me OKB-në dhe burimi i informacionit për prodhimin e indikatorit. Ecuria e çdo indikatorit paraqitet me grafik interaktiv.

INSTAT prej vitesh ka të ngritur UN INSTAT Joint Data Group, një grup i përbërë me anëtarë nga të gjithë agjensitë e UN me qëllim bashkëpunimin e ngushtë për të dhëna dhe Axshtendën 2030 në fokus.

Komuniteti statistikor i kushton shumë rëndësi OZHQ-ve. Në takimet e ndryshme organizuar nga Komisioni Statistikor i Kombeve të Bashkuara, UNECE dhe Eurostat, Indikatorët Statistikore të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm kanë patur një rëndësi të veçantë në

axhendën e tyre. Në këtë kontekst, Konferenca e Statistikanëve Evropianë, në qershor të vitit 2021, ka miratuar udhërrëfyesin e dytë të UNECE për statistikat për OZHQ-të, ku dhe INSTAT ka dhënë kontributin e tij. <https://unece.org/statistics/publications/CES-roadmap-sdg-2>. Ky botim përmban 9 Kapituj si dhe 2 anekse, i cili fillon me mesazhet kyç deri te rekomandime për përgatitjen e raportimeve vullnetare si dhe raste studimore dhe iniciativa të ndryshme nga e gjithë bota në lidhje me ecurinë e OZHQ-ve.

Shqipëria, nëpërmjet INSTAT, që prej nëntorit të vitit 2019 është anëtar i Grupit të nivelit të lartë për Partneritet, Koordinim dhe Ndërtim të kapaciteteve për statistikat për Axhendën e vitit 2030 për zhvillim të qëndrueshëm i përbërë nga Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara, përfshirë agjensitë rajonale dhe ndërkombëtare si vëzhgues. <https://unstats.un.org/sdgs/hlg/members>. Që prej Nëntorit të vitit 2020, Znj. Elsa Dhuli, Drejtore e Përgjithshme e INSTAT-it, është emëruar bashkëkryetare e Grupit të Partneritetit, Koordinimit dhe Ngritjes së Kapaciteteve të Nivelit të Lartë për Statistikat për Axhendën e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030 (HLG-PCCB).

HLG-PCCB synon të krijojë një partneritet global për të dhëna të zhvillimit të qëndrueshëm. Ato raportojnë çdo vit pranë Komisionit të Statistikave dhe sigurojnë udhëheqje strategjike për procesin e zbatimit të qëllimit të zhvillimit të qëndrueshëm pasi ka të bëjë me monitorimin dhe raportimin statistikor.

Botimi vjen me indikatorë të rinj të prodhuar si dhe në të dyja gjuhët, Shqip dhe Anglisht.

1 PA VARFËRI






**Zhdukja e varfërisë në të gjitha format e
saj në të gjithë botën.**

Zhdukja e varfërisë ekstreme për të gjithë njerëzit kudo që janë deri në vitin 2030, është qëllimi kryesor i Agjendës për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030. Midis viteve 2015 dhe 2018, varfëria globale vazhdoi rënien e saj historike, me shkallën e varfërisë që ra nga 10,1 për qind në 2015 në 8,6 për qind në 2018. Parashikuesit sugjerojnë se për shkak të pandemisë COVID-19, shkalla e varfërisë globale u rrit ndjeshëm nga 8,3 për qind në 2019 në 9,2 për qind në 2020, që përfaqëson rritjen e parë të varfërisë ekstreme që nga viti 1998 dhe rritjen më të madhe që nga viti 1990, duke frenuar uljen e varfërisë me rreth tre vjet.

Ndikimi i pandemisë COVID-19, përmbysi progresin e qëndrueshëm të uljes së varfërisë gjatë 25 viteve të fundit. Ky ndryshim i paprecedentë po përkeqësohet më tej nga rritja e inflacionit dhe ndikimet e luftës në Ukrainë. Vlerësohet se këto kriza të kombinuara do të çojnë 75-95 milionë njerëz të tjerë që jetojnë në varfëri ekstreme në vitin 2022, krahasuar me parashikimet para pandemisë.

1.2.1 Përqindja e popullsisë që jeton nën kufirin kombëtar të varfërisë. [të dhënat më të fundit 2021]

- 22,0 % në rrezik për të qenë të varfër;
+0,2 pp krahasuar me 2020




▲ +0,2 pp krahasuar me 2020

22,0 % në rrezik për të qenë të varfër

1.2.2 Përqindja e popullsisë që jeton në rrezik për të qenë të varfër ose përjashtim social AROPE, sipas gjinisë dhe grupmoshës. *(të dhënat më të fundit 2021)*

- 43,9 % në rrezik për të qenë të varfër ose përjashtim social AROPE;
+0,5 pp krahasuar me 2020

Rreziku për të qenë i varfër ose përjashtim social i referohet individëve që janë në rrezik për të qenë të varfër, ose thellësisht të privuar materialisht, ose që jetojnë në familje me intensitet shumë të ulët në punësim.



▲ +0,5 pp krahasuar me 2020

43,9 % në rrezik për të qenë të varfër ose përjashtim social AROPE

2 ZERO URI



Eliminimi i urisë, arritja e sigurisë
ushqimore dhe përmirësimi i ushqyerjes, si
dhe nxitja e bujqësisë së qëndrueshme.

Objektivi 2 i Zhvillimit të Qëndrueshëm ka të bëjë me krijimin e një bote pa uri deri në vitin 2030. Në vitin 2020, nga 720 milionë deri në 811 milionë persona në mbarë botën vuanin nga uria, afërsisht 161 milionë më shumë se në vitin 2019. Gjithashtu në vitin 2020, 2,4 miliardë njerëz, ose mbi 30 për qind e popullsisë së botës, ishin mesatarisht pa akses të rregullt në ushqyerjen e duhur. Shifra u rrit me afro 320 milionë njerëz në vetëm një vit. Në nivel global, 149,2 milionë fëmijë nën 5 vjeç, ose 22,0 për qind, vuanin nga moszhvillimi, frenimi i rritjes (gjatësia e ulët për moshën e tyre) në vitin 2020, një rënie nga 24,4 për qind në 2015.

Numri i njerëzve të uritur dhe që vuanin nga pasiguria ushqimore ishte rritur gradualisht midis 2014 dhe fillimit të pandemisë COVID-19. Kriza e COVID-19 i ka shtyrë ato norma në rritje edhe më të larta dhe gjithashtu ka përkeqësuar të gjitha format e kequshqyerjes, veçanërisht te fëmijët. Lufta në Ukrainë po prish më tej zinxhirët global të furnizimit me ushqim dhe po krijon krizën më të madhe globale të ushqimit që nga Lufta e Dytë Botërore.

2.2.1 Prevalenca e shkurtësisë (gjatësi për moshën <-2 devijimi standard nga mediana e Standardeve të Rritjes së Fëmijëve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) ndërmjet fëmijëve nën moshën 5 vjeç. *(të dhënat më të fundit 2021)*

- Prevalenca e shkurtësisë
11 % e fëmijëve nën moshën 5 vjeç;
-11,0 pp krahasuar me 2005.



▼ -11,0 pp krahasuar me 2005

11 % e fëmijëve nën moshën 5 vje

2.2.2 Prevalenca e kequshqyerjes (peshë për gjatësi $>+2$ ose <-2 devijim standard nga mesatarja e Standardeve të Rritjes së Fëmijëve të (OBSh) ndërmjet fëmijëve nën moshën 5 vjeç sipas llojit (nën-peshë dhe mbipeshë) *(të dhënat më të fundit 2021)*

- Prevalenca e nënpeshës tek fëmijët 1,6 % e fëmijëve nën moshën 5 vjeç; -7,5 pp krahasuar me 2008 - 2009.
- Prevalenca e mbipeshës tek fëmijët 9,9 % e fëmijëve nën moshën 5 vjeç; -11,8 pp krahasuar me 2008-2009.



▼ -7,5 pp krahasuar me 2008 - 2009

1,6 % e fëmijëve nën moshën 5 vje



▼ -11,8 pp krahasuar me 2008-2009

9,9 % e fëmijëve nën moshën 5 vje

3 SHËNDET I MIRË DHE MIRËQENIE



Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë në të gjitha moshat.

Sigurimi i një jete të shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies në të gjitha moshat, është thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm. Pandemia e COVID-19 vazhdon të përhapë vuajtje njerëzore. Deri në mes të vitit 2022, COVID-19 infektoi më shumë se 500 milionë njerëz në mbarë botën.

Vlerësimet e fundit tregojnë se "vdekjet shitesë" globale, që i atribuohen drejtpërdrejt dhe indirekt COVID-19 mund të përlllogariten rreth 15 milionë deri në fund të vitit 2021. Pandemia ndërpreu shërbimet thelbësore shëndësore në mënyrë drastike, duke shkaktuar rritje të prevalencës së ankthit dhe depresionit, ujle të jetëgjatësisë globale, stopimin e luftës kundër parandalimit të HIV-it, tuberkulozit (TB) dhe malarjes. Si rezultat, mbulimi i imunitetit dështoi për herë të parë në 10 vjet dhe vdekjet si pasojë e tuberkulozit dhe malarias u rritën. Nevojitet ndërhyrje e menjëhershme dhe e përbashkët për ta kthyer botën në një trajektore drejt arritjes së Objektivit 3.

3.1.2 Përqindja e lindjeve të ndjekura nga personeli i kualifikuar shëndetësor. *(të dhënat më të fundit 2021)*

- 99,97 % e lindjeve janë asistuar nga personel i kualifikuar shëndetësor për vitin 2021
-0,01 pp krahasuar me 2020

▼ -0,01 pp krahasuar me 2020

99,97 % e lindjeve janë asistuar nga
personel i kualifikuar shëndetësor



3.6.1 Shkalla e vdekjeve të shkaktuara nga aksidentet e trafikut rrugor për 100 mijë banorë. *(të dhënat më të fundit 2021)*

- 7,0 vdekje nga aksidentet rrugore për 100 mijë banorë;
+9,9 % krahasuar me 2020



▲ +9,9 % krahasuar me 2020

7,0 vdekje nga aksidentet
rrugore për 100 mijë banorë

3.b.1 Përqindja e popullatës e vaksinuar nga të gjitha vaksinat që janë të përfshira në programin kombëtar të vendit. *[të dhënat më të fundit 2021]*

- 95,8 % mbulesa vaksinale për Difteri, Tetanoz, Kolla e mirë; -2,7 pp krahasuar me 2020
- 95,0 % mbulesa vaksinale për Pneumokokun; +2,6 pp krahasuar me 2020
- 89,2 % mbulesa vaksinale për Fruthin; -1,8 pp krahasuar me 2020



▼ -2,7 pp krahasuar me 2020

95,8 mbulesa vaksinale për
Difteri, Tetanoz, Kolla e mirë



▲ +2,6 pp krahasuar me 2020

95,0 mbulesa vaksinale për
Pneumokokun



▼ -1,8 pp krahasuar me 2020

89,2 mbulesa vaksinale
për Fruthin

3.7.2 Koeficienti i lindshmërisë në adoleshencë (10-14 ose 15-19 vjeç), i shprehur për 1.000 femra të grupmoshës respektive. *(të dhënat më të fundit 2021)*

- 12,1 lindje për 1.000 femra të grupmoshës 15-19 vjeç për 2021
-9,0 % krahasuar me 2020



▼ -9,0 % krahasuar me 2020

12,1 lindje për 1.000 gra të grupmoshës
15-19 vjeç për vitin 2021

4 ARSIM CILËSOR



**Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës
dhe të barabartë dhe promovimi i
mundësive të të nxënit gjatë gjithë jetës
për të gjithë.**

Ofrimi i arsimit cilësor për të gjithë, është thelbësor për krijimin e një bote paqësore dhe të begatë. Arsimi u jep njerëzve njohuritë dhe aftësitë që u nevojiten për të qëndruar të shëndetshëm, për të gjetur punë dhe për të nxitur tolerancën. Megjithatë, pandemia e COVID-19, ka shkaktuar një krizë globale arsimore. Shumica e sistemeve arsimore në botë janë prekur rëndë nga ndërprerjet e arsimit dhe janë përballur me sfida të paprecedentë. Mbyllja e shkollave, shkaktuar nga pandemia, ka pasur pasoja shkatërruese për mësimin dhe mirëqenien e fëmijëve. Vlerësohet se 147 milionë fëmijë, humbën më shumë se gjysmën e mësimëve të tyre në klasë gjatë dy viteve të fundit. Ky brez fëmijësh mund të humbasë një total prej 17 trilion dollarësh të ardhura gjatë jetës në vlerën aktuale. Mbyllja e shkollave ka prekur më shumë vajzat, fëmijët me prejardhje të pafavorizuara, ata që jetojnë në zonat rurale, fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët nga pakicat etnike sesa bashkëmoshatarët e tyre.

4.1.1 Përqindja e popullsisë 18-24 vjeç që ka arritur në arsimin e mesëm të ulët dhe nuk është përfshirë në asnjë shkollim apo trajnim (as formal, as joformal) në katër javët para studimit. *(të dhënat më të fundit 2021)*

- 17,1 % për femrat; +1,6 pp krahasuar me 2020.
- 17,8 % për meshkujt; +2,1 pp krahasuar me 2020.
- 17,4 % për të rinjtë gjithsej; +1,8 pp krahasuar me 2020.



▲ +1,6 pp krahasuar me 2020

17,1 % për femrat



▲ +2,1 pp krahasuar me 2020

17,8 % për meshkujt



▲ +1,8 pp krahasuar me 2020

17,4 % për të rinjtë gjithsej

4.4.1 Përqindja e të rinjve dhe të rriturve me aftësi të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), sipas llojit të aftësive. *(të dhënat më të fundit 2022)*

- 24,7 % e popullsisë 16-74 vjeç ka aftësi TIK në: krijimin e prezantimeve ose dokumentave duke integruar tekste, piktura, tabela apo grafikë;
+6,0 pikë përqindje krahasuar me vitin 2021



▲ +6,0 pp krahasuar me vitin 2021

24,7 % e popullsisë 16-74 vjeç ka aftësi në krijimin e prezantimeve

4.2.2 Shkalla e pjesëmarrjes në të mësuarit e organizuar (një vit para moshës fillestare zyrtare), sipas gjinisë. (të dhënat më të fundit 2021)

- Shkalla e pjesëmarrjes së fëmijëve 92,9 %, +6,6 pp krahasuar me 2020
- Shkalla e pjesëmarrjes së djemve 95,1 %, +6,5 pp krahasuar me 2020
- Shkalla e pjesëmarrjes së vajzave 90,6 %, +6,6 pp krahasuar me 2020



▲ +6,6 pp krahasuar me 2020

92,9 % Shkalla e pjesëmarrjes së fëmijëve



▲ +6,5 pp krahasuar me 2020

95,1 % Shkalla e pjesëmarrjes së djemve



▲ +6,6 pp krahasuar me 2020

90,6 % Shkalla e pjesëmarrjes së vajzave

4.5.1 Indekset e barazisë (femrat/meshkujt, rurale/urbane, pjesa më e madhe e të ardhurave dhe të tjerat si gjendja e aftësisë së kufizuar, popujt indigjenë dhe konfliktet e prekura, kur të dhënat bëhen të disponueshme] për të gjithë treguesit e arsimit në këtë listë që mund të ndahen. *(të dhënat më të fundit 2021)*

- Indeksi i barazisë gjinore për arsimin parashkollor 0,98, +0,02 pp krahasuar me 2020
- Indeksi i barazisë gjinore për arsimin 9 vjeçar 0,94, pa ndryshim krahasuar me 2020
- Indeksi i barazisë gjinore për arsimin e mesëm 0,91, -0,02 pp krahasuar me 2020
- Indeksi i barazisë gjinore për arsimin e lartë 1,48, -0,06 pp krahasuar me 2020



1,00 Meshkuj



0,98 Femra

▲ +0,02 pp krahasuar me 2020

Indeksi i barazisë gjinore për arsimin parashkollor



1,00 Meshkuj



0,94 Femra

pa ndryshim krahasuar me 2020

Indeksi i barazisë gjinore për arsimin 9 vjeçar



1,00 Meshkuj



0,91 Femra

▼ -0,02 pp krahasuar me 2020

Indeksi i barazisë gjinore për arsimin e mesëm



1,00 Meshkuj



1,48 Femra

▼ -0,06 pp krahasuar me 2020

Indeksi i barazisë gjinore për arsimin e lartë

5 BARAZIA GJINORE



**Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi
i të gjitha grave dhe vajzave.**

Barazia gjinore nuk është vetëm një e drejtë themelore e njeriut, por një themel i domosdoshëm për një botë paqësore, të begatë dhe të qëndrueshme. Ka pasur progres gjatë dekadave të fundit, por bota nuk është në rrugën e duhur për të arritur barazinë gjinore deri në vitin 2030. Pasojat sociale dhe ekonomike nga pandemia COVID-19, e kanë bërë situatën edhe më të zymtë. Përparimi në shumë fusha, duke përfshirë kohën e shpenzuar për kujdesin e papaguar dhe punën në shtëpi, vendimmarrjen në lidhje me shëndetin seksual dhe riprodhues, dhe buxhetimin e duhur ndaj gjinisë, po lihet pas.

Shërbimet shëndetësore ndaj grave, që deri më sot kanë një financim të dobët, janë përballur me ndërprerje të mëdha. Dhuna ndaj grave mbetet e përhapur. Pavarësisht leadershipit të grave në përgjigjen ndaj COVID-19, ato ende janë nuk sigurojnë pozicione vendimmarrëse që meritojnë. Nevojitet angazhim dhe veprim i guximshëm për të përshpejtuar progresin, duke përfshirë promovimin e ligjeve, politikave, buxheteve dhe institucioneve që avancojnë barazinë gjinore. Investimi më i madh në statistikat gjinore është jetik, pasi më pak se gjysma e të dhënave të nevojshme për monitorimin e Objektivit 5 janë aktualisht në dispozicion.

5.2.1 Përqindja e grave dhe vajzave të moshës 15 vjeçare e më të moshuar që janë nënshtruar dhunës fizike, seksuale ose psikologjike nga një partner i tanishëm apo ish-intim në 12 muajt e mëparshëm, sipas formës së dhunës dhe sipas moshës. *(të dhënat më të fundit 2018)*


- 33,7 % Dhuna psikologjike ose seksuale ose fizike



33,7 % Dhuna psikologjike ose
seksuale ose fizike

5.5.1 (a) Përqindja e vendeve që mbahen nga gratë në parlament. *(të dhënat më të fundit 2021)*

- 37,7 % e grave;
+8,2 pp krahasuar me 2020.



▲ +8,2 pp krahasuar me 2020

37,7 % Përqindja e ulëseve që mbahen
nga gratë në parlament

5.5.1 (b) Përqindja e vendeve të mbajtura nga gratë në qeveritë lokale, 2019.
[të dhënat më të fundit 2018]


- 43,7 % e grave



43,7 % Përqindja e vendeve të mbajtura nga gratë në qeveritë lokale

5.5.2 Përqindja e grave në pozicione manaxheriale. *(të dhënat më të fundit 2021)*

- 35,5 % e grave; +0,1 pp krahasuar me 2020



▲ +0,1 pp krahasuar me 2020

35,5 % Përqindja e grave në pozicione manaxheriale

6 UJË I PASTËR DHE SHËRBIME SANITARE



**Sigurimi i disponueshmërisë dhe
menaxhimit të qendrueshëm të ujit
dhe shërbimeve sanitare për të gjithë.**

Aksesi në ujë të rrjedhshëm, shërbime sanitare dhe higjienë është nevoja më themelore e njeriut për shëndet dhe mirëqenie. Miliarda njerëzve do t'u mungojë akses në këto shërbime bazë në vitin 2030, nëse përparimi nuk katërfishohet. Kërkesa për ujë po rritet për shkak të rritjes së shpejtë të popullsisë, urbanizimit dhe rritjes së nevojave për ujë nga sektorët e bujqësisë, industrisë dhe energjisë.

Dekada keqpërdorimi, menaxhimi i dobët, nxjerrja e tepërt e ujërave nëntokësore dhe ndotja e furnizimeve me ujë të ëmbël kanë përkeqësuar cilësinë e ujit. Përveç kësaj, vendet po përballen me sfida në rritje të lidhura me ekosistemet e degraduara të lidhura me ujin, mungesën e ujit të shkaktuar nga ndryshimet klimatike, investimet e pamjaftueshme në ujë dhe shërbime sanitare dhe bashkëpunimin e pamjaftueshëm në ujërat ndërkufitare.


Për të arritur akses universal në ujin e rrjedhshëm, shërbime sanitare dhe higjienën deri në vitin 2030, ritmet aktuale të progresit do të duhet të katërfishohen. Arritja e këtyre objektivave do të shpëtonte 829,000 njerëz në vit, të cilët vdesin nga sëmundjet që i atribuohen drejtpërdrejt ujit jo të pijshëm, shërbimeve sanitare të pamjaftueshme dhe praktikave të dobëta higjienike.

6.1.1 Përqindja e popullsisë që përdor shërbimet e ujit të pijshëm të menaxhuara në mënyrë të sigurtë. *(të dhënat më të fundit 2021)*

- Përqindja e popullsisë që furnizohet me ujë të pijshëm në familje:
90,5 % e popullsisë;
-0,1 pp krahasuar me 2020.

▼ -0,1 pp krahasuar me 2020

90,5 % e popullsisë që përdor shërbimet e ujit të
pijshëm të menaxhuara në mënyrë të sigurtë



6.2.1 Përqindja e popullsisë që përdor shërbime sanitare të menaxhuara në mënyrë të sigurtë, duke përfshirë larjen e duarve me sapun dhe ujë. *(të dhënat më të fundit 2021)*

- Përqindja e popullsisë me tualet në banesë/ndërtesë:
96,9 % e popullsisë;
+1,9 pp krahasuar me 2020.

▲ +1,9 pp krahasuar me 2020

96,9 % e popullsisë që përdor shërbime
sanitare të menaxhuara në mënyrë të sigurtë



7 ENERGJI E PËRBALLUESHME DHE E PASTËR



Sigurimi i furnizimit me energji me kosto
të përballueshme, të besueshme, të
qëndrueshme dhe moderne për të gjithë.


Objektivi 7 ka të bëjë me sigurimin e aksesit në energji të pastër dhe të përballueshëm i cili është kyç për zhvillimin e bujqësisë, biznesit, komunikimit, arsimit, kujdesit shëndetësor dhe transportit. Mungesa e aksesit në energji pengon zhvillimin ekonomik dhe njerëzor.

Të dhënat e fundit, sugjerojnë se bota vazhdon të përparojë drejt objektivave të qëndrueshëm të energjisë. Megjithatë, ritmi aktual i progresit është i pamjaftueshëm për të arritur objektivin 7 deri në vitin 2030. Vazhdojnë pabarazitë e mëdha në aksesin ndaj energjisë moderne të qëndrueshme.

Rritja e çmimeve të mallrave, energjisë dhe transportit ka rritur koston e prodhimit dhe transportit të moduleve fotovoltaike diellore, turbinave të erës dhe biokarburanteve në mbarë botën, duke shtuar pasigurinë në një trajektore zhvillimi që është tashmë e theksuar nën ambiciet e Objektivit 7. Arritja e objektivave të energjisë dhe klimës do të kërkojë mbështetje të vazhdueshme të politikave dhe një mobilizim masiv të kapitalit publik dhe privat për energji të pastër dhe të rinovueshme, veçanërisht në vendet në zhvillim.

7.1.2 Përqindja e popullsisë që mbështetet në burime kryesore në lëndë djegëse të pastra dhe teknologjike. *(të dhënat më të fundit 2021)*

- 42,5 % e popullsisë; +4,95 pikë përqindje krahasuar me vitin 2020




▲ +4,95 pp krahasuar me vitin 2020

42,5 % e popullsisë që mbështetet
në burime kryesore në lëndë
djegëse të pastra dhe teknologjike

7.2.1 Pjesa e energjisë së rinovueshme në totalin e konsumit final të energjisë. *(të dhënat më të fundit 2021)*

- 41,4% e totalit të konsumit final të energjisë; -3,6 pp krahasuar me 2020



▼ -3,6 pp krahasuar me 2020

41,4% e totalit të konsumit final të energjisë

8 PUNË DINJITOE DHE RRITJE EKONOMIKE



Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë.

Rritja ekonomike e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse mund të nxisë përparimin, krijimin e vendeve të punës të denja për të gjithë dhe të përmirësojë standardet e jetesës.

COVID-19 ka ndërprerë jetën e miliarda njerëzve dhe ka rrezikuar ekonominë globale. Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) pret një recesion global po aq të keq ose më keq sesa në vitin 2009. Ndërsa humbjet e vendeve të punës përshkallëzohen, Organizata Ndërkombëtare e Punës, vlerëson se gati gjysma e fuqisë punëtore globale rrezikon të humbasë të ardhurat e jetesës.

Edhe para shpërthimit të COVID-19, një në pesë vende – shtëpia e miliarda njerëzve që jetojnë në varfëri – kishte të ngjarë të shihte të ardhurat për frymë të bien në vitin 2020. Tani, goditjet ekonomike dhe financiare të lidhura me COVID-19, të tilla nga ndërprerjet në prodhimin industrial, rënia e çmimeve të mallrave, paqëndrueshmëria e tregjeve financiare dhe rritja e pasigurisë, po dëmtojnë rritjen ekonomike tashmë të vakët, së bashku me rreziqet e rritura nga faktorë të tjerë.


8.3.1 Përqindja e të punësuarve informalë në sektorin jo-bujqësor. *(të dhënat më të fundit 2021)*

- 29,4 % gjithsej; +0,3 pp krahasuar me 2021
- 34,8 % për meshkujt; +0,7 pp krahasuar me 2021
- 21,4 % për femrat; -0,5 pp krahasuar me 2021



▲ +0,3 pp krahasuar me 2021

29,4 % gjithsej



▲ +0,7 pp krahasuar me 2021

34,8 % për meshkujt



▼ -0,5 pp krahasuar me 2021

21,4 % për femrat

8.6.1 Përqindja e të rinjve (15-24 vjeç) jo në punësim, jo në training dhe as duke ndjekur shkollën. *(të dhënat më të fundit 2021)*

- 24,0 % për të rinjtë gjithsej; 2,6 pp krahasuar me 2020
- 22,1 % për meshkujt; 5,0 pp krahasuar me 2020
- 25,9 % për femrat; 0,3 pp krahasuar me 2020



▼ -2,6 pp krahasuar me 2020

24,0 % për të rinjtë gjithsej



▼ -5,0 pp krahasuar me 2020

22,1 % për meshkujt



▼ -0,3 pp krahasuar me 2020

25,9 % për femrat

9 INDUSTRI, NOVACION DHE INFRASTRUKTURË



**Ndërtimi një infrastrukture rezistuese,
promovimi i industrializimit të
qëndrueshëm dhe promovimi i inovacionit.**

Industrializimi gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm, së bashku me inovacionin dhe infrastrukturën, mund të çlirojë forca ekonomike dinamike dhe konkurruese që gjenerojnë punësim dhe të ardhura. Ato luajnë një rol kyç në prezantimin dhe promovimin e teknologjive të reja, lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare dhe duke mundësuar përdorimin efikas të burimeve. Megjithatë, bota ka ende një rrugë të gjatë për të bërë për të shfrytëzuar plotësisht këtë potencial. Vendet më pak të zhvilluara, në veçanti, duhet të përshpejtojnë zhvillimin e sektorit të tyre të prodhimit nëse duan të përmbushin objektivin e vitit 2030 dhe të rrisin investimet në kërkimin shkencor dhe inovacionin.

Rritja globale e prodhimit ka qenë në rënie të vazhdueshme, edhe para shpërthimit të pandemisë COVID-19. Pandemia po godet fort industrinë prodhuese dhe po shkakton ndërprerje në zinxhirët e vlerës globale dhe furnizimin e produkteve.

Inovacioni dhe përparimi teknologjik janë çelësi për gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme si për sfidat ekonomike ashtu edhe për ato mjedisore, të tilla si rritja e burimeve dhe efienca e energjisë. Globalisht, investimet në kërkim dhe zhvillim (R&D) si përqindje e PBB-së u rritën nga 1,5 përqind në 2000 në 1,7 përqind në 2015 dhe mbetën pothuajse të pandryshuara në 2017, por ishin vetëm më pak se 1 përqind në rajonet në zhvillim. Për sa i përket infrastrukturës së komunikimit, më shumë se gjysma e popullsisë së botës është tani online dhe pothuajse e gjithë popullata botërore jeton në një zonë të mbuluar nga një rrjet celular. Vlerësohet se në vitin 2019, 96,5 % mbulohehin nga të paktën një rrjet 2G.

9.1.2 Volumi i mallrave dhe pasagjerëve, sipas mënyrës së transportit. *(të dhënat më të fundit 2021)*

1. Numri i pasagjerëve sipas mënyrës së transportit

- 2.928.275 pasagjerë me ajër; +123,4 % në krahasim me 2020
- 862.757 pasagjerë me det; +127,6 % në krahasim me 2020
- 24.018 pasagjerë me hekurudhë; +33,8 % në krahasim me 2020

2. Volumet e mallrave sipas mënyrës së transportit

- 2 (000/ton) Transport mallrash me ajër; +13,3 % në krahasim me 2020
- 4.840 (000/ton) Transport mallrash me det; +13,2 % në krahasim me 2020
- 632 (000/ton) Transport mallrash me hekurudhë; +0,5 % në krahasim me 2020



▲ +123,4 % në krahasim me 2020

2.928.275 pasagjerë me ajër



▲ +127,6 % në krahasim me 2020

862.757 pasagjerë me det



▲ +33,8 % në krahasim me 2020

24.018 pasagjerë me hekurudhë

9.2.2 Punësimi në industrinë përpunuese si përqindje e punësimit gjithsej. (të dhënat më të fundit 2021)

- 13,5 % për femrat; -0,6 pp krahasuar me 2020
- 9,4 % për meshkujt; +0,6 pp krahasuar me 2020
- 11,2 % për të punësuarit gjithsej; 0,0 pp krahasuar me 2020



▼ -0,6 pp krahasuar me 2020

13,5 % për femrat



▲ +0,6 pp krahasuar me 2020


9,4 % për meshkujt



0,0 pp krahasuar me 2020

11,2 % për të punësuarit gjithsej

10 ZVOGËLIM I PABARAZIVE



Ulja e pabarazive brenda një
vendi dhe mes vendeve të tjera.


Zvogëlimi i pabarazive dhe sigurimi që askush të mos mbetet prapa, janë pjesë përbërëse e arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Pabarazia brenda dhe midis vendeve është një shkak i vazhdueshëm për shqetësim.

Efektet e pandemisë COVID-19, duket se po përmbysin çdo tendencë pozitive të ngushtimit të pabarazisë së të ardhurave. Pandemia gjithashtu ka intensifikuar diskriminimin strukturor dhe sistemik. Tregjet në zhvillim dhe ekonomitë në zhvillim po përjetojnë rikuperime të ngadalta, duke zgjeruar pabarazitë në të ardhura midis vendeve. Numri i vdekjeve të refugjatëve dhe emigrantëve në mbarë botën arriti numrin më të lartë absolut të regjistruar në vitin 2021.

Ndërkohë, lufta në Ukrainë vazhdon, duke detyruar edhe më shumë njerëz të largohen nga shtëpitë e tyre dhe duke krijuar një nga krizat më të mëdha të refugjatëve.

10.1.1 Ndryshimi vjetor në përqindje i raportit të të ardhurave disponibël të ekuivalentuara midis 40 përqindëshit të popullsisë me të ardhura më të ulta dhe popullsisë totale. *[të dhënat më të fundit 2021]*


- Ndryshimi vjetor në përqindje i raportit të të ardhurave disponibël të ekuivalentuara midis 40 përqindëshit të popullsisë me të ardhura më të ulta dhe popullsisë totale është 0,3 %;
-4 pp krahasuar me ndryshimin vjetor të 2020




10.2.1 Përqindja e popullsisë që jetojnë nën 50 përqind të medianës së të ardhurave disponibël të ekuivalentuara. *(të dhënat më të fundit 2021)*

- 15,0 % e popullsisë jetojnë nën 50 % të medianës së të ardhurave disponibël të ekuivalentuara; +0,6 pp krahasuar me vitin 2020


0-17 vjeç




18-64 vjeç



65+ vjeç



Totali



▲ +0,6 pp krahasuar me 2020

15,0 % e popullsisë që jetojnë nën 50 përqind të medianës së të ardhurave disponibël të ekuivalentuara

11 QYTETE DHE KOMUNITETE TË QËNDRUESHME



**Bërja e qyteteve dhe vendbanimeve
njerëzore përfshirëse, të sigurta, të forta
e të qëndrueshme.**

Bota po urbanizohet gjithnjë e më shumë. Që nga viti 2007, më shumë se gjysma e popullsisë së botës ka jetuar në qytete dhe kjo përqindje parashikohet të rritet në 60 për qind deri në vitin 2030.

Qytetet dhe zonat metropolitane janë fuqitë e rritjes ekonomike – duke kontribuar rreth 60 për qind të PBB-së globale. Megjithatë, ato përbëjnë gjithashtu rreth 70 për qind të emetimeve globale të karbonit dhe mbi 60 për qind të përdorimit të burimeve.


Urbanizimi i shpejtë po rezulton në një numër në rritje të banorëve të lagjeve të varfëra, infrastrukturë dhe shërbime të papërshtatshme dhe të mbingarkuara, (siç janë grumbullimi i mbeturinave dhe sistemet e ujit dhe kanalizimeve, rrugët dhe transporti), përkeqësimi i ndotjes së ajrit dhe shtrirja e paplanifikuar urbane.

Ndikimi i COVID-19, do të jetë më shkatërrues në zonat urbane të varfra dhe me popullsi të dendur, veçanërisht për një miliard njerëz që jetojnë në vendbanime informale dhe lagje të varfëra në mbarë botën, ku mbipopullimi gjithashtu e bën të vështirë ndjekjen e masave të rekomanduara si distanca sociale dhe izolimi.

Agjencia e OKB-së për ushqim, FAO, paralajmëroi se uria dhe viktimat mund të rriten ndjeshëm në zonat urbane, pa masa për të siguruar që banorët e varfër dhe të cënueshëm të kenë akses në ushqim.

11.1.1 Përqindja e popullsisë urbane që jeton në lagjet e varfra, vendbanimet jo formale ose strehime jo të përshtatshme. *(të dhënat më të fundit 2021)*

- Përqindja e popullsisë që jeton në lagje të varfra
20,31% e popullsisë;
-0,5 pp krahasuar me 2020



20.31% Përqindja e popullsisë urbane që jeton në lagjet e varfra,
vendbanimet jo formale ose strehime jo të përshtatshme

11.6.1 Raporti i mbetjeve të ngurta urbane të mbledhura rregullisht dhe të depozituara sipas normave, ndaj sasisë gjithsej mbetjeve të ngurta urbane të gjeneruara. *(të dhënat më të fundit 2021)*

- Përqindja e mbetjeve të ngurta urbane të mbledhura dhe depozituara rregullisht 91,6 % e sasisë gjithsej;
+2,3 pp krahasuar me 2020



▲ +2,3 pp krahasuar me 2020

12 KONSUM DHE PRODHIM I PËRGJEGJSHËM



Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të
konsumit dhe prodhimit.

Konsumi dhe prodhimi mbarëbotëror – një forcë lëvizëse e ekonomisë globale – mbështeten në përdorimin e mjedisit natyror dhe burimeve në një mënyrë që vazhdon të ketë ndikime shkatërruese në planet.


Progresi ekonomik dhe social gjatë shekullit të kaluar është shoqëruar me degradim mjedisor që po rrezikon vetë sistemet nga të cilat varet zhvillimi ynë i ardhshëm – në të vërtetë, vetë mbijetesa jonë.

Pandemia e COVID-19, u ofron vendeve një mundësi për të ndër-tuar plane rikuperimi që do të ndryshojnë tendencat aktuale dhe do të ndryshojnë modelet tona të konsumit dhe prodhimit drejt një të ardhmeje më të qëndrueshme.

Konsumi dhe prodhimi i qëndrueshëm ka të bëjë me të bërit më shumë dhe më mire, me më pak burime. Ka të bëjë gjithashtu me shkëputjen e rritjes ekonomike nga degradimi i mjedisit, rritjen e efikasitetit të burimeve dhe promovimin e stileve të qëndrueshme të jetesës. Konsumi dhe prodhimi i qëndrueshëm gjithashtu mund të kontribuojnë në mënyrë thelbësore në zbutjen e varfërisë dhe tranzicionin drejt ekonomive me karbon të ulët dhe të gjelbër.

12.2.2 Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore, përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore në raport me popullsinë dhe përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore në raport me PBB. *[të dhënat më të fundit 2021]*

- Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore në raport me popullsinë:
6,8 tonë për banorë;
-14,0 pp krahasuar me 2020
- Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore:
19.284 (000 tonë);
-14,0 pp krahasuar me 2020



▼ -14,0 pp krahasuar me 2020

19.284 (000 tonë) Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore

12.5.1 Shkalla e riciklimit kombëtar, sasia në tonë e mbetjeve që riciklohen. (të dhënat më të fundit 2021)

- Mbetje urbane të ricikluara:
166 tonë;
-12,33 pp krahasuar me 2020.
- Shkalla e riciklimit:
18,8 % e sasisë gjithsej;
+13,87 pp krahasuar me 2020.



▲ +13,87 pp krahasuar me 2020

18.8 % Shkalla e riciklimit

13 VEPRIM PËR KLIMËN



**Ndërmarrja e veprimeve urgjente për
të luftuar ndryshimin e klimës dhe
efektet e tij.**




Temperatura globale tashmë është rritur $1,1^{\circ}\text{C}$, mbi nivelin para-industrial, me shkrirjen e akullnajave dhe rritjen e nivelit të detit. Ndikimet e ndryshimeve klimatike përfshijnë gjithashtu përmbytjet dhe thatësirën, zhvendosjen e miliona njerëzve, fundosjen e tyre në varfëri dhe uri, mohimin e aksesit në shërbimet bazë, si shëndetësia dhe arsimi, zgjerimi i pabarazive, mbytja e rritjes ekonomike dhe madje edhe shkaktimi i konflikteve. Deri në vitin 2030, rreth 700 milionë njerëz do të jenë në rrezik të zhvendosjes vetëm nga thatësira.

Prandaj, ndërmarrja e veprimeve urgjente për të luftuar ndryshimin e klimës dhe ndikimet e tij shkatërruese është thelbësore për të shpëtuar jetë, për të bërë realitet Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe 17 Objektivat e saj – plani për një të ardhme më të mirë.

Në vitin 2020, përqendrimet globale të gazeve serrë arritën nivele të reja maksimale dhe të dhënat në kohë reale tregojnë për rritje të vazhdueshme. Me rritjen e këtyre përqendrimeve, rritet edhe temperatura e Tokës. Në vitin 2021, temperatura mesatare globale ishte rreth $1,1^{\circ}\text{C}$ mbi nivelin para-industrial (nga 1850 deri në 1900). Vitet nga 2015 deri në 2021 ishin shtatë vitet më të ngrohta të regjistruara.

Për të kufizuar ngrohjen në $1,5^{\circ}\text{C}$ mbi nivelet para-industriale, siç përcaktohet në Marrëveshjen e Parisit, emetimet globale të gazeve serrë do të duhet të arrijnë kulmin përpara vitit 2025. Më pas ato duhet të ulen me 43 për qind deri në vitin 2030 dhe në zero deri në vitin 2050. Vendet po flasin për plane veprimi për klimën për të ulur emetimet dhe për t'iu përshtatur ndikimeve klimatike nëpërmjet kontributeve të përcaktuara në nivel kombëtar. Megjithatë, angazhimet aktuale kombëtare nuk janë të mjaftueshme për të përmbushur objektivin $1,5^{\circ}\text{C}$.

14 JETA NËN UJË



**Ruajtja dhe shfrytëzimi i
qëndrueshëm i oqeanëve, deteve
dhe burimeve detare për zhvillim të
qëndrueshëm.**



Objektivi 14 ka të bëjë me ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të oqeanëve, deteve dhe burimeve detare. Oqeanet dhe detet e shëndetshme janë thelbësore për ekzistencën njerëzore dhe jetën në Tokë. Ata mbulojnë 70 % të planetit dhe ofrojnë ushqim, energji dhe ujë. Oqeani thith rreth një të katërtën e emetimeve vjetore të dioksidit të karbonit (CO₂) në botë, duke zbutur kështu ndryshimin klimatik dhe duke lehtësuar ndikimet e tij.

Është thelbësore që ato të ruhen dhe të përdoren në mënyrë të qëndrueshme. Megjithatë, aktiviteti njerëzor po rrezikon oqeanet dhe detet – ekosistemin më të madh të planetit – dhe po ndikon në jetesën e miliarda njerëzve.

15 JETA NË TOKË



Mbrojtja, rimëkëmbja dhe nxitja e shfrytëzimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, pyjeve të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme, luftimi i shkretëtimit, ndalimi dhe prapësimi i procesit të degradimit të tokës, si dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit.

Natyra është thelbësore për mbijetesën tonë: natyra na siguron oksigjenin, rregullon modelet tona të motit, fertilizon të korrat tona, prodhon ushqimin dhe fibrat që na nevojiten. Aktiviteti njerëzor ka ndryshuar pothuajse 75 % të sipërfaqes së tokës, duke zvogëluar jetën e egër dhe natyrën në një cep gjithnjë e më të vogël të planetit.

Rreth 1 milion specie shtazore dhe bimore kërcënohen me zhdukje – shumë prej tyre brenda një dekade – sipas Raportit të Vlerësimit Global të 2019-ës, për Shërbimin e Biodiversitetit dhe Ekosistemit. Raporti bëri thirrje për ndryshime transformuese për të rivendosur dhe mbrojtur natyrën. Ai zbuloi se shëndeti i ekosistemeve nga të cilat, ne dhe të gjitha speciet e tjera varem, po përkeqësohet më shpejt se kurrë, duke ndikuar në vetë themelet e ekonomive tona, mjetet e jetesës, sigurinë ushqimore, shëndetin dhe cilësinë e jetës në mbarë botën.

Shpyllëzimi dhe shkretëtizi – i shkaktuar nga aktivitetet njerëzore dhe ndryshimet klimatike – paraqesin sfida të mëdha për zhvillimin e qëndrueshëm dhe kanë ndikuar në jetën dhe jetesën e miliona njerëzve. Pyjet janë thelbësore për ruajtjen e jetës në Tokë dhe luajnë një rol të madh në luftën kundër ndryshimeve klimatike. Investimi në restaurimin e tokës është kritik për përmirësimin e jetesës, reduktimin e dobësive dhe reduktimin e rreziqeve për ekonominë.

15.1.1 Zona pyjore si pjesë e sipërfaqes së përgjithshme të tokës. *(të dhënat më të fundit 2021)*

- Sipërfaqja e pyjeve si përqindje ndaj sipërfaqes gjithsej të tokës
39,89 % e sipërfaqes gjithsej;
+3,30 pp krahasuar me 2020.



▲ +3,30 pp krahasuar me 2020

39.89 % Sipërfaqja e pyjeve

16 PAQE, DREJTËSI DHE INSTITUCIONE TË FORTA



Promovimi i shoqërive paqësore dhe
përfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm,
ofrim i aksesit në drejtësi për të gjithë
dhe ndërtimi i institucioneve efektive,
llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të
gjitha nivelet.



Konflikti, pasiguria, institucionet e dobëta dhe aksesit i kufizuar në drejtësi mbeten një kërcënim i madh për zhvillimin e qëndrueshëm.


Numri i njerëzve që arratisen nga lufta, persekutimi dhe konflikti, tejkaloi 70 milionë në vitin 2018, niveli më i lartë i regjistruar nga agjencia e OKB-së për refugjatët (UNHCR) në pothuajse 70 vjet.

Në vitin 2019, Kombet e Bashkuara, regjistruan 357 vrasje dhe 30 zhdukje me forcë të mbrojtësve të të drejtave të njeriut, gazetarëve dhe sindikalistëve në 47 vende.

Lindjet e rreth 1 në 4 fëmijë nën moshën 5 vjeç në mbarë botën, nuk regjistrohen kurrë zyrtarisht, duke i privuar ata nga një dëshmi e identitetit ligjor, thelbësor për mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe për aksesin në drejtësi dhe shërbime sociale.

16.1.1 Numri i viktimave të vrasjeve me dashje për 100.000 banorë sipas gjinisë. *(të dhënat më të fundit 2021)*

- 2,3 viktima për 100.000 banorë; +0,2 pp krahasuar me 2020
- 0,8 viktima femra për 100.000 banore femra; +0,2 pp krahasuar me 2020
- 3,9 viktima meshkuj për 100.000 banorë meshkuj; +0,2 pp krahasuar me 2020



16.2.2 Numri i viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore për 100.000 banorë, sipas gjinisë, moshës dhe formës së shfrytëzimit. *(të dhënat më të fundit 2021)*

- 5,7 viktima për 100.000 banorë; +2,7 pp krahasuar me 2020
- 7,0 viktima femra për 100.000 banore femra; +2,6 pp krahasuar me 2020
- 4,3 viktima meshkuj për 100.000 banorë meshkuj; +2,6 pp krahasuar me 2020



▲ +2,7 pp krahasuar me 2020

**5,7 viktima për
100.000 banorë**



▲ +2,6 pp krahasuar me 2020

**7,0 viktima femra për
100.000 banore femra**



▲ +2,6 pp krahasuar me 2020

**4,3 viktima meshkuj për
100.000 banorë meshkuj**

17 PARTNERITETI PËR OBJEKTIVAT



**Forcimi i mjeteve të zbatimit dhe
rivitalizimi i Partneritetit Global për
Zhvillim të Qëndrueshëm**



OZHQ-të, mund të realizohen vetëm me partneritete dhe bashkëpunim të fortë global.

Një agjendë e suksesshme zhvillimi, kërkon partneritete gjithëpërfshirëse – në nivel global, rajonal, kombëtar dhe lokal – të ndërtuar mbi parime dhe vlera dhe mbi një vizion të përbashkët dhe qëllime të përbashkëta që vendosin njerëzit dhe planetin në qendër.

Shumë vende kërkojnë Asistencë Zyrtare për Zhvillim për të inkurajuar rritjen dhe tregtinë. Megjithatë, nivelet e ndihmës po bien dhe vendet donatore nuk e kanë përmbushur zotimin e tyre për të rritur financimin e zhvillimit.

Për shkak të pandemisë COVID-19, ekonomia globale parashikohet të tkurret ndjeshëm, me 3 %, në vitin 2020, duke përjetuar recesionin e saj më të keq që nga Depresioni i Madh.

Një bashkëpunim i fortë ndërkombëtar është i nevojshëm tani më shumë se kurrë, për të siguruar që vendet të kenë mjetet për t'u rikuperuar nga pandemia, për t'u rikthyer më të fortë dhe për të arritur Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

17.1.1 Të ardhurat totale të qeverisë si pjesë e PBB-së, sipas burimit. *(të dhënat më të fundit 2021)*

- **+27,02%; +1,11 pp krahasuar me vitin 2020**
- Ndihamat: +0,67 %; +0,17 pp krahasuar me vitin 2020
- Të ardhura tatimore: +25,17 %; +0,92 pp krahasuar me vitin 2020
- Të ardhura jo-tatimore: +1,18 %; +0,03 pp krahasuar me vitin 2020



▲ +0,17 pp krahasuar me 2020

Ndihamat: +0,67



▲ +0,92 pp krahasuar me 2020

Të ardhura tatimore: +25,17



▲ +0,03 pp krahasuar me 2020

Të ardhura jo-tatimore: +1,18

17.1.2 Proporcioni i buxhetit të brendshëm financiar nga taksat vendore. [të dhënat më të fundit 2021]

- +79,80 %; +5,47 pp krahasuar me vitin 2020



▲ +5,47 pp krahasuar me 2020

+79,80 % Proporcioni i buxhetit të brendshëm financiar nga taksat vendore

Footnote: Semi-final estimations of GDP for year 2020 / Estimations of GDP for year 2021 are based on quarterly data.

17.3.2 Volumi i remitancave (në dollarë amerikanë) si përqindje e PBB-së totale. *(të dhënat më të fundit 2021)*

- +9,41 %;
-0,43 pp krahasuar me vitin 2020




▼ -0,43 pp krahasuar me vitin 2020

9,41% Volumi i remitancave (në dollarë amerikanë) si përqindje e PBB-së
totale

17.8.1 Përqindja e individëve që përdorin Internetin. *[të dhënat më të fundit 2022]*

- 82,6 % e individëve të moshës 16-74 vjeç kanë përdorur internet nga çdo vendodhje gjatë tre muajve të fundit; +3,3 pikë përqindje krahasuar me vitin 2021.



▲ +3,3 pp krahasuar me 2021

82,6 % e individëve të moshës 16-74 vjeç kanë përdorur internet gjatë tre muajve të fundit

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Instituti i Statistikave

OBJEKTIVAT E Zhvillimit të Qëndrueshëm : Shqipëria
2022 / Instituti i Statistikave ; drejt. bot.
Elsa Dhuli. - Tiranë : INSTAT, 2023

... f. : me il. ; ... cm.

ISBN 978-9928-390-05-9

1. Statistika 2. Shqipëri

311.312(496.5) "2022"

OBJEKTIVAT

E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

Shqipëria 2022

